

AKT SHUMELIMI

Mbështetur në ligjin nr. 7512 dt. 10.8.91 "Për funksionimin e mbrojtjes së veprimtarisë private të nismës së lirë të veprimtarisë të pavarura të privatizimit" si dhe të ligjit nr. 7696 dt. 7.4.93

Për shërbimin e rojeve civile "unë Mark Vecaj me vullnetin tim të lirë dhe me dëshirën time mora vendimin të krijoj shoqëri të private për organizimin e shërbimit të rojeve civile me emrin

SH P K .

Selia e kësaj shoqërie ndodhen në qytetin e Shkodrës në lagjen

Kapitali i kësaj shoqërie është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Veprimtaria private e kësaj shoqërie do të jetë marrja në ruajtje me roje civile të objekteve në pronësi ose në përdorim të personave juridik ose civil ose fizik, shqiptar ose të huaj, si banka arka e kursimeve, magazina e lëndëve të para për produkte industriale e bujqësore, magazina e lokale tregtije, rep. prodhimi zyra e seli firmash, banesa private, si dhe çdo objekt tjetër ku ruhet vlera pasurore. Sigurimi i objekteve ku ruhet vlera pasurore monetare e materiale, stacionare ose në lëvizje në të gjitha llojet e transportit. Pranimi i kërkesave në ruajtje me roje civile të objekteve në pronësi ose në përdorim të personave juridik ose fizik shqiptar ose të huaj, në përputhje me pikën 5 të rregullores nr. 129 dt. 18.5.93.

Pranimi i kërkesave nga shtetas shqiptar dhe përzgjedhjen të kandidatëve që kërkojnë të ushtrijnë profesionin si roje civile në përputhje me nenin 4 të ligjit Nr. 7696 dt. 7.4.93.

Dërgimi për miratimin e organeve të rendit publik të kërkesave të shtetasve shqiptar dhe të dhënies të lejes së ushtrimit të profesionit privat të personave që miratohen nga organe kompetente shtetërore konform nenit 3 dhe 5 të ligjit Nr. 7696 dt. 7.4.93.

ORTAK I VETËM

Mark Vecaj



## AKT KONSTRUKTIV

### I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### "MIRI" SHPK

Ne Tirane ne daten \_\_09.2001 (dymije e nje) une i nenshkuari Mark Vecaj , i biri i Tomes dhe i Marijes, dtl. 1956, lindur ne Rrashkullaj, banues ne Shkoder , me cilesine e ortakut te vetem, me vullnetin tim te lire e te plote vendosa te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "MIRI" Sh.p.k me qender Shkoder.

#### HYRJE

##### NENI 1

Ne kuptim te ketij Akti themelues eshte Mark Vecaj, ortaku i vetem themelues i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MIRI".

##### NENI 2

Drejtues teknik i shoqerise "MIRI" eshte z. Gjovalin Kosteri , i cili ka te drejtat dhe detyrimet qe percakton ligji 8770, date 19.04.2001 dhe aktet e tjera nenligjore ne fuqi.

##### NENI 3

Qellimi i ketij akti themelues eshte krijimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MIRI" shpk me seli ne Tirane dhe me perspektive shtrirje ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

##### Neni 4

Shoqeria "MIRI"Sh.p.k eshte person juridik dhe veprimtaria e saj zhvillohet sipas Statutit, Ligjit Nr.8770,date19.04.2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike" dhe akteve te tjera te legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

2.

## OBJEKTI

### NENI 5

Sipas Ligjit Nr. 8770 Dt. 19.04.2001, objekti i veprimtarise se Shoqerise "MIRI" e pajisur me licencen e kategorise "a", "b" dhe "a+b" do te jete: ruajtja e sigurimi i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike me veprimtari ne Republikën e Shqiperise dhe Sigurimin e Mbrojtjen e Jetes e Shendetit te Personave Fizike, shtetas shqiptare ose te huaj, shoqerimin e vlerave monetare ose te sendeve te cmuara gjate transportimit te tyre sipas kontrates qe do te lidhet ndermjet kesaj shoqerie dhe personave juridike apo fizike qe kerkojne mbrojtjen e objekteve dhe jetes se tyre.

### NENI 6

Shoqeria "MIRI" Sh.p.k do te filloje aktivitetin e saj nga data e rregjistrimit ne regjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane, si dhe pajisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve te rajonit perkates.

### NENI 7

Shoqeria "MIRI" Sh.p.k do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe 7 vjecare, me te drejte perseritje.

## KAPITALI I SHOQERISE

### NENI 8

Kapitali Themeltar i Shoqerise "MIRI" Sh.p.k eshte 4.000.000 (kater milion) leke.

Ortaku i vetem Mark Vecaj e disponon kete shume baraz me 100% e nenshkrueshme dhe e shlyeshme prej tij.

## BILANCI, VEPRIMTARIA EKONOMIKE, DETYRIMET

### NENI 9

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore, sigurimet shoqerore etj.

3.

NENI 10

Ortaku i vetem themelues ose persona te tjere te autorizuar prej tij kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve ekonomike, te perfitojne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

JURIDIKSIONI

NENI 11

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MIRI" Sh.p.k e ka qendren e saj ne Tirane.

NENI 12

Shoqeria "MIRI" Sh.p.k ushtron aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 13

Te gjitha mosmarreveshjet me persona fizike ose juridike vendas ose te huaj si dhe organet shteterore, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

THEMELUESI  
MARK VECAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE  
Nr. 2356 Rep.

VERTETIM

Vertetojme se sot, me date 24.09.2001, para meje noteres u paraqit kerkuesi Mark Vecaj, per identitetin e te cilit pasi u sigurova nga pasaporta, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se sa me siper u be me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe nenshkroi para meje noteres, dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERIA  
AFER QENDRES TIRANE



STATUTI  
I SHOQERISE PRIVATE TE RUAJTJES (SH.P.R.)  
"MIRI"

Sot, me daten 24.09.2001 (dymije e nje) Mark Vecaj , i biri i Tomes dhe i Marijes, dtl. 1956, lindur ne Rrashkullaj, banues ne Shkoder, i cili ka vendosur te krijoje shoqerine private te ruajtjes ne mbeshtetje te ligji nr. 8770, dt. 19.04.2001 "Per shoqerine e sigurimit e ruajtjes fizike " (SH.P.R.) dhe Udhezimet e Ministrit te Rendit Publik nr. 1487, 1488, 1489, 1490, 1491 e 1492, dt. 21.06.2001. Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet duke u mbeshtetur ne dispozitat e ketij statuti qe do te beje dhe aktin baze te rregullimit, struktures e organizimit.

KREU I

Emertimi, selia, objekti, jetegjatesia

NENI 1

Krijohet shoqeria e ruajtjes dhe sigurime fizike ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e qe shkurt do te quhet shoqeria "MIRI" shpk.

NENI 2

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MIRI" shpk eshte ne Tirane. Ajo gezon te drejten per te hapur filiale, dege apo agjensi te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit.

NENI 3

Sipas Ligjit Nr. 8770 Dt. 19.04.2001, objekti i veprimtarise se Shoqerise "MIRI" e pajisur me licencen e kategorise "a", "b" dhe "a+b" do te jete: ruajtja e sigurimi i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike me veprimtari ne Republikën e Shqiperise dhe Sigurimin e Mbrojtjen e Jetes e Shendetit te Personave Fizike, shtetas shqiptare ose te huaj, shoqerimin e vlerave monetare ose te sendeve te cmuara gjate transportimit te tyre sipas kontrates qe do te lidhet ndermjet kesaj shoqerie dhe personave juridike apo fizike qe kerkojne mbrojtjen e objekteve dhe jetes se tyre.



2.

#### NENI 4

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare "MIRI " SHPK shpk eshte 7 vjet, me te drejte riperteritje. Nuk perjashtohet mundesia qe per arsye te perligjura dhe te justifikuara shoqeria ta pushoje aktivitetin e saj dhe para afatit 7 vjecar, duke njoftuar per kete qellim organet e Ministrise se Rendit Publik qe kane leshuar licensen – lejen per aktivitetin e mesiperm.

#### NENI 5

Vendndodhja ligjore e personave te kontraktuar nga shoqeria dhe te pajisur me lejen perkatese nga organet e rendit ne raport me shoqerine eshte ajo qe rezulton nga libri (lista) e anetareve te miratuar nga organet e rendit publik te rrethit e ato qendrore.

#### KREU II

#### KAPITALI

#### NENI 6

Kapitali Themeltar i Shoqerise "MIRI" Sh.p.k i investuar totalisht nga administrator i vetem Mark Vecaj eshte 4.000.000 (kater milion) leke per aktivitetin e shoqerise ne baze te ligjit nr.8770, date 19.04.2001.

#### NENI 6

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Ortaku i Vetem.

#### NENI 7

Me miratimin e administratorit te vetem nuk perjashtohet mundesia e hyrjes se ortakut ne shoqeri duke i transferuar kuotat sipas marreveshjes se arritur midis atij dhe administratorit te shoqerise.

3.  
KREU III  
ORTAKU I VETEM  
NENI 8

Shoqeria tregtare " MIRI " shpk eshte prone e Ortakut te vetem te saj, i cili gezon te gjitha atributet e Asamblese se Shoqerise. Administrator shoqerise do te jete Mark Vecaj. Ai si administrator i vetem i shoqerise vendos per gjishcka qe lidhet me aktivitetin, organizimin, ndarjen e punes, caktimin e detyrave te pergjithshme e te vecanta, kontrollin per zbatimin e tyre dhe marrjen e masave perkatese per mospermbushjen e rregullt nga cilido punonjes. Per drejtimin teknik shoqeria sipas ligjit 8770, dt. 19.04.2001 eshte z. Gjovalin Kosteri i cili ka detyrat dhe te drejtat qe percaktohen ne kete ligj.

NENI 9

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise ortakut emeron e puneson administratore te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga shoqeria ose largohen me deshiren e tyre. Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetentat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji i jep shprehimisht Ortakut te Vetem.

KREU IV  
ADMINISTRIMI  
NENI 10

Administrimi i shoqerise "MIRI" shpk i perket ortakut te vetem, i cili eshte njekohesisht edhe administrator. Me zgjerimin e aktivitetit te shoqerise nuk perjashtohet mundesia qe detyrimin e administrimit ta kryej edhe nje person tjeter kundrejt te drejtave qe do t'i besohen nga ortakut i vetem.

NENI 11

Punesimi i personave ne shoqeri qe duan dhe pranojne te kryejne aktivitetin e sherbimit te ruajtjes dhe sigurimit fizik behet kundrejt kontrates se lidhur midis secilit dhe administratorit te vetem te shoqerise. Me zgjerimin e aktivitetit te shoqerise mund te pajtohen ne pune edhe persona te tjere qe do te jene ne ndihme dhe funksion te sherbimit te ruajtjes. Drejtuesi teknik ben pergatitjen e punonjesve qe kerkojne te punesohen ne shoqeri dhe ploteson

4.

detyrimet ne baze te ligjit per pajisjen me licence te ushtrimit te profesionit si punonjes sherbimi, ben pregatitjen dhe kualifikimin teoriko-praktik te personelit ne perputhje me teknikat bashkekohore dhe dispozitat ne fuqi.

KREU I V  
BILANCI DHE TE ARDHURAT  
NENI 12

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakut te vetem te saj. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdorim Ortakut te vetem te saj.

NENI 13

Pasuria e shoqerise eshte lirisht e trashegueshme ne rruge trashegimie.

SHPERBERJA E SHOQERISE  
NENI 14

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak. Ne rast mbylljeje Ortaku i vetem vendos mbi menytrat e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat. Ne rastin e likuidimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER. Mbase behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqeria cregjistrohet nga regjistri tregtar i asaj gjykate.

DISPOZITA TE TJERA

NENI 15

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga ortakut i saj.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE  
MARK VECAJ

